



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 8, datë 20.02.2017

Për

**“NJË NDRYSHIM NË MËNYRËN E PAGESËS PËR BANDËN DHE ANSAMBLIN
FOLKLORIK TË QENDRËS KULTURORE “TIRANA””**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, dhe nenit 54 shkronja “ç” dhe “dh”, nenit 55 pika 3 të Ligjit Nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.71, datë 27.12.2007, për “Riorganizimin e Qendrës Kulturore “Tirana” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84, datë 29.12.2016, për “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”, Urdhrit të Kryetarit Nr. 4240/2, datë 01.02.2017, shkresës me nr.prot 44 datë 03.02.2017 të Qendrës Kulturore “Tirana”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë një ndryshim në mënyrën e pagesës për Bandën dhe Ansamblin Folklorik të Qendrës Kulturore “Tirana” si vijon:

Pagesa për artistët e Bandës dhe Ansamblit Folklorik të Qendrës Kulturore “Tirana” të jetë 13,000 lekë në muaj për çdo artist.

2. Efektet financiare të këtij vendimi, fillojnë nga 1 Janari i vitit 2017 dhe përballohen nga artikulli 602 (Shpenzime operative) të planifikuara në buxhetin e Qendrës Kulturore “Tirana” për vitin 2017.
3. Të shfuqizojë pikën 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 27.12.2007.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Qendra Kulturore Tirana si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI